



Prishtinë, 15.08.2008
Kodi i ZRRE-së: D_109_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Nenin 15, 26 dhe Kreun 7 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Nenin 3 dhe 6 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe
3. Aplikacionit për licencë furnizim/tregti me energji elektrike të datës 21.03.2008 të ndërmarrjes “INTERENERGO KOSOVA Inxhinjeringu energjetik” Sh.p.k, Nëna Terezë nr. 33, Prishtinë, Kosovë, në seancën e mbajtur më datë 15 gusht 2008, nxori këtë:

VENDIM

- I. **I LËSHOHET** licenca për furnizim/tregti me energji elektrike ndërmarrjes “INTERENERGO KOSOVA Inxhinjeringu energjetik” Sh.p.k.
 1. Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 21.03.2008 ka pranuar nga kompania në fjalë aplikacionin për licencë Furnizim/Tregti me energji elektrike.
 2. ZRRE me datë 26.03.2008 dhe 07.04.2008 ka bërë vlerësimin në detaje të çdo dëshmie të dërguar dhe ka vlerësuar se aplikacioni dhe dëshmitë e dërguara janë në përputhje me kërkesat që dalin nga Rregulli për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjislacionin e aplikueshëm për energjinë në Kosovë.
 3. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
 4. Palët e pakënaqura mund të paraqesin ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose nga data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
 5. Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij nga Bordit i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE:

Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtar

Nysret Avdiu, anëtar